



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister

Zyra për Komunikim Publik/ Ured za Javno Komuniciranje/ Public Communication Office

RAPORT GJITHËPËRFSHIRËS
I INSTITUCIONEVE PUBLIKE PËR REALIZIMIN E SË DREJTËS PËR QASJE
NË DOKUMENTE PUBLIKE

Raporti vjetor 2015

Prishtinë, mars 2016

Përmbajtja

	Faqe
1. Përmbledhje	3
2. E drejta e qasjes në dokumente publike	
2.1 Parimet themelore	4
2.2 Rregullimi i së drejtës për qasje në dokumente publike	5
2.3 Rregullimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Kosovë	7
2.3.1 Aktet juridike	7
3. Aktivitetet në zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike	
3.1 Zbatimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe sfidat në procesin e punës	8
3.2 Raportet lidhur me lirinë e informimit	8
4. Kërkesat për qasje në dokumente publike	
4.1 Institucionet e mbuluara me Ligjin Nr. 03/ L-215 për Qasje në Dokumente Publike	11
4.2 Institucionet që nuk kanë dërguar raporte	12
4.2 Të dhënat e përgjithshme	13
4.2.1 Numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës	14
4.2.2 Realizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në institucionet e Republikës së Kosovës	15
4.3 Presidenca, Kuvendi i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese.....	16
4.4 Qeveria e Republikës së Kosovës	21
4.5 Universitetet publike	31
4.6 Institucionet e Pavarura	35
4.7 Ndërmarrjet Publike	40
4.8 Komunat e Republikës së Kosovës	42
5. Shtojcat	
- Formulari i kërkesës për qasje në dokumente publike	47
Lista e kontakteve	8

HARTUES I RAPORTIT:
ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT

Albulena Sylaj-Zeqiri, Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun dhe Trajtimin e Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike

1 PËRMBLEDHJE

Zyra për Komunikim me Publikun e Zyrës së Kryeministrit, në pajtueshmëri me Ligjin Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, përgatitë Raport Gjithëpërfshirës vjetor për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Ky është Raporti i pestë me radhë që publikohet.

Sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, institucionet e Republikës së Kosovës janë të obliguara të mbajnë evidenca zyrtare për kërkesat për qasje, të cilat duhet të përmbledhen në raport.

Në Raportin Gjithëpërfshirës për vitin 2015, fillimisht janë të prezantuara të dhënat e përgjithshme mbi realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike në nivel vendi.

Në vazhdim të raportit, këto të dhëna janë prezantuar të detajuara në pjesën e raportimit për institucionet qendrore, Qeverinë, përfshirë agjencitë vartëse, komunat, universitetet, ndërmarrjet publike dhe institucionet e pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës.

Raporti përmban edhe analiza me grafikone për realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike, dokumentet kryesore që janë kërkuar, profili i aplikuesve, por edhe për arsyet kryesore të refuzimeve.

Pos kësaj, në fillim janë të shkruara parimet themelore që rregullojnë këtë fushë, instrumentet ligjore ndërkombëtare, si dhe aktet juridike që e rregullojnë këtë fushë në Kosovë.

Krejt në fund, për të ndihmuar edhe më shumë kërkuarit në realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike, është dhënë lista e kontakteve të zyrtarëve përgjegjës në institucione publike, për pranimin dhe procedimin e kërkesave në qasje në dokumente publike.

2 E DREJTA E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE

2.1 Parimet themelore

Në demokraci, është e nevojshme që njerëzit të kenë qasje në një numër të madh të informatave, në mënyrë që të marrin pjesë në mënyrë reale dhe efektive në çështjet që ndikojnë në ta. Organizata ndërkombëtare joqeveritare "Access Info", thotë se trupat publike janë, dhe duhet të jenë "në shërbim të popullit".

Standardet ndërkombëtare dhe juridike kanë konfirmuar se informatat i takojnë publikut. Konventa e Këshillit të Evropës për Qasje në Dokumente Zyrtare, e vitit 2009, e ka rregulluar këtë çështje në këtë mënyrë: "të gjitha dokumentet zyrtare në princip janë publike dhe mund të jenë subjekt i refuzimit vetëm për të mbrojtur të drejtat tjera dhe interesat tjera legjitime". Në vijë me këtë, qasja në informata është njohur si e drejtë fundamentale e njeriut nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Organizata ndërkombëtare joqeveritare me seli në Londër, "Article 19"¹, ka numëruar këto parime themelore:

- **Hapje maksimale** – Principi i hapjes maksimale krijon supozimin dhe të gjitha informatat e mbajtura nga institucionet publike duhet të jenë të hapura, me përjashtime shumë të limituara.
- **Obligimi për të publikuar** – Institucionet publike duhet të jenë të obliguara që të publikojnë proaktivisht informatat kyçe që i mbajnë
- **Promovimi i qeverisjes së hapur** – Informimi i publikut për të drejtën e tyre për qasje në informacion është i domosdoshëm, por poashtu edhe promovimi i në kulture për të hapur informacionet brenda vetë qeverisë
- **Rastet e kufizuara të përjashtimeve** – Përjashtimet duhet të jenë të qarta dhe narrative, dhe subjekt të "testit të dëmit" dhe "testit të interesit publik".
- **Proces për të ndihmuar qasjen** –Kërkesat për qasje në informacion duhet të procedohen shpejt dhe paanshëm. Poashtu duhet të sigurohet një mbikëqyrje nga një institucion i pavarur i të gjitha refuzimeve
- **Shpenzimet** - Institucionet nuk duhet të ngarkojnë kërkuesin e dokumenteve me shpenzime të tepërta.
- **Takime të hapura** – Liria e informimit përfshin të drejtën e publikut për të ditur se çfarë qeveria po bën në emrin e tyre, dhe për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.
- **Hapja kërkon precedent** – Ligji për qasje në dokumente publike duhet të kërkoj që legjislacioni tjetër të interpretohet, për aq sa është e mundur, në një mënyrë që është në përputhje me dispozitat e Ligjit për qasje në dokumente publike
- **Mbrojtja e sinjalizuesve** – Individët të cilët publikojnë informata për keqëbërjen e institucioneve ku punojnë- duhet të mbrohen. Këta individ duhet të mbrohen nga çfarëdo sanksioni, ligjor, administrativ dhe të mos kërcënohen me humbjen e vendit të tyre të punës.

¹ http://avada.access-info.org/ep-content/uploads/Article_19_principles_on_the_public_right_to_knoë.pdf

Në Kosovë, Ligji për Qasje në Dokumente Publike bazohet në dhjetë parimet mbi të drejtën për qasje në informata:²

1. Qasja në informata është e drejtë e secilit;
2. Qasja është rregull- sekreti është përjashtim;
3. E drejta aplikohet tek të gjitha organet publike;
4. Bërja e kërkesës duhet të jetë e thjeshtë, e shpejtë dhe e lirë;
5. Zyrtarët kanë për detyrë t'u ndihmojnë kërkuuesve të informatave ;
6. Refuzimi duhet të arsyetohet;
7. Interesi publik është më i rëndësishëm se sekreti;
8. Secili ka të drejtë të ankohe ndaj vendimit të pafavorshëm;
9. Organet publike duhet në mënyrë proaktive të publikojnë

informatat thelbësore;

10. E drejta duhet të garantohet nga një organ i pavarur.

2.2 Rregullimi i së drejtës për qasje në dokumente publike

Qasja në dokumente publike është e mbrojtur me konventa të shumta të të drejtave të njeriut

Këto instrumente ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë përparësi në rast konflikti ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Më poshtë janë të radhitura instrumentet kryesore ndërkombëtare që e sigurojnë këtë të drejtë.³

Kombet e Bashkuara

Më e rëndësishmja prej tyre konsiderohet Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 217 A (III), 10 dhjetor 1948.

Neni 19 i kësaj Deklarate thotë:

Secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes së mendimit; kjo e drejtë përfshin lirinë për të shprehur pikëpamjet e tij pa ndërhyrje dhe të kërkoj, marrë dhe jap informata dhe ide nëpërmes çfarëdo medie dhe pa marrë parasysh kufijtë.

- Konventa Aarhus (Konventa për qasje në informim, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në çështjet e drejtësisë në mjedis) Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara, 25 qershor 1998
- Konventa kundër korrupsionit, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 58/4 të datës 31 tetor 2003.
- Komenti i përgjithshëm numër 34, Komiteti për të drejta njerëzore i Kombeve të Bashkuara, 12 shtator 2011, që përbën një interpretim autoritativ të lirisë së shprehjes, e garantuar nga Neni 19 e

² PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR TË DREJTËN E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE, Përgatitur nga: BESIM M. KAJTAZI

<http://ëëë.kryeministri->

[ks.net/repository/docs/I_PERMBLEDHJE_LEGJISLACIONI_PER_TE_DREJTEN_E_QASJES_NE_DOKU.pdf](http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/I_PERMBLEDHJE_LEGJISLACIONI_PER_TE_DREJTEN_E_QASJES_NE_DOKU.pdf)

³ <http://ëëë.right2info.org/international-standards>

Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, e cila është e detyrueshme në më shumë se 165 shtete.

- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 2200 A (XXI), 16 dhjetor 1966 (neni 19) dhe Protokollin e Parë Opsional

Këshilli i Evropës

- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Fundamentale, Këshilli i Evropës, 4 nëntor 1950 (Neni 10)
- Konventa për Qasje në Dokumente Zyrtare, 27 nëntor 2008, dhe Raporti Shpjegues.
- Deklarata e Lirisë së Shprehjes dhe Informimit, Komiteti i Ministrave, sesioni i 70-të, 29 prill 1982.
- Rekomandimet CM/Rec(2008) 6 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me Masat për promovimin dhe Respektimin e Lirisë së Shprehjes dhe Informimit që lidhen me filtrat e internetit, 26 mars 2008.
- Rekomandimet Rec (2002) 2 të Komitetit të Ministrave për Qasjen në Dokumente Zyrtare, 21 shkurt 2002.
- Rekomandimet No. R (81) 19 të Komitetit të Ministrave për Qasjen në Informatat e mbajtura nga Autoritetet Publike, 25 nëntor 1981.

Bashkimi Evropian

- Kapitulli i të Drejtave Themelore të Unionit Evropian OJ C 364, 18 dhjetor 2000 (Neni 42). Garanton të drejtën e qasjes në dokumente të mbajtura nga institucionet e Unionit Evropian për "secilin qytetar të Unionit, dhe secilit person fizik ose juridik që banon ose ka zyrë të regjistruar në Shtetet Anëtare".

- Direktiva 2003/4/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për Qasjen e Publikut në Informatat e Mjedisit, OJ 2003 L 41/26, 28 janar 2003.

- Rregullorja (EC) No 1049/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me Qasjen e Publikut në dokumentet e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit, OJ 2001 L 145, 30 maj 2001.

- Traktati i Unionit Evropian dhe Deklarata për të Drejtën e Qasjes në Informacion, OJ C 191, 29 korrik 1992.

- Traktati i Lisbonës, 2007/C 306/01, Lisbonë, 13 dhjetor 2007 zgjeron përmbledhjen e institucioneve në Rregulloren e Komisionit Evropian, e cila duhet të aplikohet nga të gjitha institucionet e Unionit Evropian dhe ndaj të gjithë aplikuesve.

- Direktiva 2013/37/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 26 qershor 2013, që amendamenton Direktivën 2003/98/EC për ripërdorimin e informatave të sektorit publik.

2.3 Rregullimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Kosovë

E drejta për qasje në dokumente të institucioneve publike të Kosovës hyn në kuadër të të drejtave dhe lirive themelore të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Secili individ e gëzon të drejtën për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e parasheh të drejtën për qasje në dokumente publike në nenin 41. Në frymën e këtij neni, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Qasje në Dokumente Publike më 7 tetor, 2010.

2.3.1 Aktet juridike

Qasja në dokumente publike në Republikën e Kosovës rregullohet me këto akte juridike:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton:

"1. Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike."

"2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë."

- Ligji Nr.03/ L-215 për Qasje në Dokumente Publike

Ligji për Qasje në Dokumente Publike garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.

Në funksion të zbatimit me sukses të Ligjit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar:

- ▶ Rregullorja nr. 03/2011 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun;
- ▶ Rregullorja nr. 1/2012 për Kodin e Etikës për zyrtarët e komunikimit me Publikun;
- ▶ Rregullorja nr. 04/2012 për evidencën zyrtare të kërkesave për qasje në dokumente publike dhe pakoja e dokumenteve standarde për kërkesat për QDP;
- ▶ Rregullore nr. 02/2012/MF për tarifatat në qasje në dokumente publike;
- ▶ Udhëzim Administrativ (MAP) nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike
- ▶ Udhëzimi Administrativ nr. 02/2011, për portalin qeveritar të Republikës së Kosovës.
- ▶ Udhëzim Administrativ nr. 2008/09 për transparencën në komuna

- Ligjet tjera të ndërlidhura

- Ligji nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale
- Ligji nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë
- Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit
- Ligji nr. 02/L-28 për procedurën administrative
- Ligji nr. 03/L-202 për konfliktet administrative
- Ligji nr. 04/L-184 për administrimin e punës në Zyrë

3 AKTIVITETET NË ZBATIMIN E LIGJIT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

3.1 ZBATIMI I LIGJIT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE DHE SFIDAT NË PROCESIN E PUNËS

Duke pas parasysh vërejtjet e dhëna nga Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit, si dhe raportet nga SIGMA, Pas shumë konsultimeve, Zyra e Kryeministrit ka nisur procesin e rishikimit të politikave të cilat rregullojnë të drejtën e qasjes në dokumente publike.

Koncepti dokumenti për qasje në dokumente publike, i hartuar gjatë vitit 2015, është shpërndarë tek organizata buxhetore si dhe shoqëria civile.

Pos kësaj, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Zyra për Komunikim Publik në ZKM ka mbajtur dy tryeza të titulluara ka “Diskutime lidhur me Konceptin dokumentin për Qasje në Dokumente Publike”, të mbajtur më 18 shtator, përkatësisht 29 tetor.

Qëllimi kryesor i punëtorisë ishte diskutimi i opsioneve se si mund të zgjidhet problemi i zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, si dhe harmonizimi i tij me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

3.2 RAPORTET LIDHR ME LIRINË E INFORMIMIT

Në klasifikimin e të Drejtës për Informim, program i financuar nga dy organizata “Access Info Europe (AIE)” dhe “Centre for Laë and Democracy”⁴, Kosova ka fituar 106 pika nga gjithsej 150 që ishin në tërësi.

Në klasifikimin e përgjithshëm, nga 103 shtete, Kosova është radhitur në vendin e 21-të.

Seksioni	Pikët maksimale	Pikët e fituara
E drejta për qasje	6	2
Gjithëpërfshirja	30	25
Procedurat për kërkesë	30	23
Përrjashtimet	30	22
Apelimi	30	21
Dënimet	8	2
Masat e promovimit	16	11
TOTALI	150	106

⁴ <http://ëëë.rti-rating.org/country-data>

Kosovo

- Law on Access to Public Documents

SECTION	MAX SCORE	SCORE
Right of Access	6	2
Scope	30	25
Requesting procedures	30	23
Exceptions	30	22
Appeals	30	21
Sanctions	8	2
Promotional measures	16	11
TOTAL	150	106


Download Report 



Figura 1.

Pikët e fituara të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, sipas vlerësimit të bërë nga programi i AccessInfo

Gjatë vitit 2015 ka pasur një numër të Raporteve për Kosovën, të cilat kanë mbuluar edhe realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike.

Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian⁵, për vitin 2015, në pjesën që flet për llogaridhënien e administratës thuhet:

“Mekanizma të jashtëm dhe të brendshëm janë themeluar për të mbrojtur të drejtën e qytetarëve për administratë të mirë. Megjithatë, mbikëqyrja nga institucionet sikur Auditori i Përgjithshëm dhe Avokati i Popullit është rreptësisht i limituar nga administrate shtetërore, të cilët i kushtojnë pak kujdes rekomandimeve të tyre. E drejta e qasjes në informata publike është e rregulluar me Ligjin për qasje në dokumente publike. Gjatë dy viteve të kaluara, numri refuzimeve apo kërkesave që nuk kanë marrë përgjigje, ishte i ulët (vetëm 5 për qind nga gjithsej 2 mijë kërkesa që janë bërë secilin vit).

Kurse në pjesën që flet për Mbrojtjen e të dhënave personale, thuhet:

“Mbrojtja e të dhënave personale është në hapat e parë. Kosova ka një autoritet të pavarur për mbrojtjen e të dhënave personale – Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale – që kontribuon në zbatimin e standardeve të BE-së në këtë fushë. Megjithatë, forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të saj, përfshirë edhe nevojën për staf të kualifikuar dhe burime financiare. Korniza institucionale dhe ligjore për Mbrojtjen e të drejtave personale dhe qasje në informata publike duhet të krijohet dhe të rregullohet. Nga 38 komuna, 35 tash kanë zyrtar për Mbrojtjen e të drejtave

⁵ http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf

personale. Agjencia ka rritur numrin e inspektimeve. Një rritje e dukshme në numrin e ankesave nga anëtarët e publikut, tregon për rritje të vetëdijes nga qytetarët”.

Në Raportet bazike të matjes nga SIGMA, të publikuar në prill të vitit 2015 dhe të titulluar “Parimet e Administratës Publike”⁶, për Ligjin flitet në pjesën e llogaridhënies së Qeverisë.

Në të thuhet se Ligji për Qasje në Dokumente Publike garanton procedurat për qasje në dokumente publike, e drejtë e garantuar me Kushtetutë, dhe vë kërkesa për publikimin proaktiv të informatave.

“Megjithatë, korniza ligjore ka mangësi, përfshirë këtu një gamë të arsyejeve për të refuzuar qasjen, mungesën e mbrojtjes efektive gjyqësore dhe mungesën e një trupe mbikëqyrëse me fuqinë e nevojshme që të urdhëroj dhe të vë dënime në rastet e dështimit të dhënies së informatave”.

Në Raportin Vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2014⁷, janë bërë disa rekomandime për institucionet kompetente, në radhë të parë për Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës:

- Të synohet shtimi i aktiviteteve për rritjen e vetëdijes për të drejtën e qasjes në dokumente publike, nëpërmjet fushatave informuese, që për synim do të kishin në rend të parë zyrtarët përgjegjës të institucioneve por edhe qytetarët në lidhje me këtë të drejtë.
- Shtimin dhe intensifikimin e trajnimeve të vazhdueshme të zyrtarëve, për të krijuar dhe trajtuar në mënyrë profesionale regjistrat e dokumenteve publike dhe për t’iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve me korrektësi dhe duke respektuar normat ligjore.
- Të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të filluar me amendamentimin e Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike, për ta bërë këtë ligj të qartë, të thjeshtë dhe të zbatueshëm.
- Të synohet krijimi i një mekanizimi me fuqi ekzekutive për trajtimin e ankesave që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike.

⁶ http://ëëë.sigmaëeb.org/publications/Baseline_Measurement_2015_Kosovo.pdf

⁷ http://ëëë.sigmaëeb.org/publications/Baseline_Measurement_2015_Kosovo.pdf

4 KËRKESAT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

4.1 Institucionet e përfshira në këtë Raport gjithëpërfshirës

Në këtë Raport janë të përfshirë të dhënat mbi 160 institucione në të gjitha nivelet, të cilat kanë obligim që të zbatojnë Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Fillimisht janë prezantuar të dhënat për tri institucione të nivelit qendror:

- Presidenca e Republikës së Kosovës
- Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Më pas, janë prezantuar të dhënat për Qeverinë, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse, me gjithsej 79 institucione.

Sa i përket institucioneve të pushtetit lokal, janë prezantuar të dhënat për 38 komuna.

Nga institucionet tjera janë përfshirë raportet për pesë universitete publike, 17 ndërmarrje publike dhe 29 institucione të pavarura, të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Nga të gjitha këto institucione, janë 4 institucione të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që nuk raportojnë, si dhe katër komuna të Republikës së Kosovës (shih 4.9)




Figura 2.

Institucionet e përfshira në Raportin Gjithëpërfshirës për realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike

4.2 INSTITUCIONET QË NUK KANË DËRGUAR RAPORTE

4.2.1 Institucionet e Republikës së Kosovës të cilat nuk kanë dërguar raporte

Mungesa e raportimit nga Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial lë jashtë raportit edhe Gjykatat dhe Prokuroritë tjera të Kosovës⁸, pasi janë pikërisht këto Këshille përgjegjëse për mbledhjen e raporteve nga institucionet e tyre vartëse dhe dërgimit të raportit tek Zyra për Komunikim në ZKM.

Më poshtë është paraqitur lista e institucioneve të cilat nuk kanë dërguar raporte për kërkesat për qasje në dokumente publike.

- Avokati i Popullit
- Agjencioni Kosovar i Inteligjencës
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- Këshilli Prokurorial i Kosovës
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

- Komunitet të cilat nuk kanë dërguar raporte

Më poshtë është tabela e komunave të cilat nuk kanë përgatitur dhe dërguar raporte për kërkesa për qasje në dokumente publike.

- Komuna e Zveqanit
- Komuna e Leposaviqit
- Komuna e Zubin Potokut
- Komuna e Shtërpces
- Komuna e Ranillugut
- Komuna e Parteshit

⁸ Rregullore nr 04/2012 për Evidencën Zyrtare të Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike, neni 5:

- pika 4: "Gjykatat raportin nga paragrafi 1 i këtij neni ia dërgojnë Këshillit Gjyqësor të Kosovës i cili përmbledh raportin dhe ia dërgon Zyrës për Komunikim me Publikun të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit;;

-pika 5: "Prokuroritë e Kosovës nga paragrafi 1 i këtij neni ia dërgojnë Këshillit Prokurorial të Kosovës i cili përmbledh raportin dhe ia dërgon Zyrës për Komunikim me Publikun të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit".

4.3 TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

4.3.1 Numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës

Tabelat e mëposhtme tregojnë pasqyrën e përgjithshme të kërkesave nga viti i kaluar deri në vitin 2011, si dhe trajtimin që kanë marrë ato nga institucionet publike.

Tabela nr. 1:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2015 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Totali
Institucionet qendrore: Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	22	2	2	26
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	785	69	33	887
Institucionet e Pavarura	205	13	1	219
Universitetet	75	0	0	75
Ndërmarrjet Publike	84	1	2	87
Komunat	789	31	18	838
Totali	1960	116	56	2132

Tabela nr. 2:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2014 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore: Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	27	2	4	0	0	33
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	736	9	25	25	56	851
Institucionet e Pavarura	201	5	0	0	1	207
Universitetet	41	1	0	1	0	43
Ndërmarrjet Publike	15	1	0	0	0	16
Komunat	846	18	9	24	26	923
Totali	1866	36	38	50	83	2073

Tabela nr. 3:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2013 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore; Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	26	2	1	0	0	29
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	1095	11	26	34	7	1173
Institucionet e Pavarura	156	6	4	2	2	170
Ndërmarrjet Publike	59	0	0	0	0	59
Komunat	497	18	19	28	6	568
Totali	1833	37	50	64	15	1999

Tabela nr.4:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2012 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucionet / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore; Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	45	1	/	/	/	47
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	540	52	8	/	15	615
Institucionet e Pavarura	79	4	1	/	2	86
Ndërmarrjet Publike	8	/	/	/	/	8
Komunat	530	36	8	/	14	588
	1202	93	17	/	31	1343

Tabela nr. 5:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2011 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore; Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	30	1	0	5	0	36
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	482	2	2	8	8	502
Institucionet e Pavarura	705	6	3	0	1	715
Komunat	1332	27	0	40	0	1399
Totali	2549	36	5	53	9	2652

4.3.2 Realizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në institucionet e Republikës së Kosovës

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit, numri i qasjes së lejuar në kërkesat për qasje në dokumente publike ka qenë dukshëm më i madh, se sa i kërkesave që janë refuzuar.




Figura 3.

Realizimi i përgjithshëm i së drejtës për qasje në dokumente publike në institucionet e Republikës së Kosovës – krahasimi i viteve

4.4 PRESIDENCA, KUVENDI I KOSOVËS DHE GJYKATA KUSHTETUESE

4.4.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Presidencë, Kuvend të Kosovës dhe Gjykatë Kushtetuese

Gjatë vitit 2015, në tri institucionet qendrore janë pranuar vetëm 26 kërkesa për qasje në dokumente publike.

Tabela më poshtë pasqyron numrin e kërkesave të parashtruara në institucionet qendrore të Republikës së Kosovës.

Tabela nr. 6:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese

Emri i institucionit	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Totali
Presidenca e Republikës së Kosovës	11	1	1	13
Kuvendi i Republikës së Kosovës	5	1	0	6
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	6	0	1	7
	22	2	2	26

4.4.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese

Tabela e më poshtme pasqyron totalin e kërkesave të parashtruara në këto institucione.

Tabela nr 6:

Totali i kërkesave të shqyrtuara në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese

Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Totali
22	2	2	26

- Realizimi i qasjes në dokumente publike

Gjatë vitit 2015, në Zyrën e Presidentes, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese, janë realizuar 84.62 për qind e të gjitha kërkesave për qasje në dokumente publike. Në 7.69 për qind të rasteve është refuzuar qasja, po aq për qind sa është lejuar edhe qasje e pjesshme.

Në figurën janë paraqitur të dhënat që prezantojnë realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike në tri institucionet e mësipërme qendrore të Republikës së Kosovës.

Realizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike




Figura 4.
Realizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Presidencë, Kuvend dhe Gjykatë Kushtetuese

- Dërgimi i përgjigjeve në kërkesa

Tri institucionet qendrore, gjatë vitit 2015 janë përgjigjur në afat ligjor në 88.46 për qind të kërkesave që i kanë marrë për qasje në dokumente publike. Të gjitha këto përgjigje janë dërguar pa pagesë.

Grafiku i mëposhtëm tregon këto përqindje.




Figura 5.
Dërgimi i përgjigjeve tek kërkuuesit nga institucionet qendrore

- Refuzimet

Në gjysmën e kërkesave të cilat janë refuzuar, tri institucionet qendrore kanë lejuar qasje të pjesshme, duke fshehur nga dokumenti vetëm pjesët të cilat nuk janë publike. Në 25 për qind të rasteve, refuzimi ka qenë i plotë, ndërsa sipas nenit 10 të Ligjit për Qasje në Dokumente publike, një kërkesë është refuzuar me heshtje administrative.

Refuzimet




Figura 6.

Mënyrat e refuzimeve të kërkesave për qasje në dokumente publike

Përveç pa përgjigje, këto institucione kanë refuzuar qasjen bazuar në nenin 12 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, pika 1.9 "Barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë".

Gjatë vitit të kaluar, në këto institucione nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtimin e çështjes.

- Forma e kërkesave të pranuar dhe e përgjigjeve të dërguara

Më së shumti, kërkesat e drejtuara tek Zyra e Presidentit, Kuvendi i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese, kanë qenë në formën elektronike, që përbën 92 për qind të të gjithë kërkesave të pranuar. Vetëm në 8 për qind të rasteve, kërkuarit kanë sjellë kërkesën e tyre në kopje fizike.




Figura 7.

Forma e kërkesave të pranuar

Në këto kërkesa, tri institucionet përgjigjet e dërguara në 69.23 për qind i kanë dërguar në formë elektronike, 23.08 për qind në kopje fizike, ndërsa në formë elektronike dhe kopje fizike në 3.85 për qind të rasteve.




Figura 8.
Mënyra e dërgimit të përgjigjeve

- Profili i aplikuesve

Gazetarët mbesin kërkuesit më të mëdhenj të dokumenteve. Vitin e kaluar, gazetarët kanë kërkuar 34.62 për qind të dokumenteve tek institucionet qendrore, nga të gjitha kërkesat e pranura gjatë vitit. Pas tyre, radhiten individët me 23.08 për qind, studentët me 19.23 për qind. Operatorët ekonomik dhe shoqëria civile kanë bërë secila nga 7.69 për qind të të gjitha kërkesave, ndërsa 3.85 nga kërkesat kanë ardhur nga organizatat buxhetore, po aq sa ka pasur edhe nga partitë politike.





Figura 9.
Profili i kërkuesve të dokumenteve

- **Dokumentet e kërkuara Presidencë, Kuvend të Kosovës dhe në Gjykatë Kushtetuese**

Tek këto tri institucione qendrore, dokumentet më të kërkuara kanë qenë ato të kategorisë së buxhetit dhe shpenzimeve, me gjithsej 26.92 për qind të të gjitha kërkesave të pranuar. 15.38 për qind të kërkesave ishin për vendime, po aq sa ishin edhe për projektligje. Më pas, më 7.69 për qind të të gjitha kërkesave, radhiten dokumentet që përmbajnë statistika, po aq sa kishte kërkesa edhe për kopje të kërkesave individuale dhe dokumente të tenderëve. Njësoj kërkesa, 3.85 për qind, kishte edhe për kontrata, si dhe raporte të ndryshme vlerësimi. Kërkesat tjera , të lidhura me natyrën e punës së këtyre institucione, ishin 11.54 për qind.



*Figura 10.
Dokumentet më të kërkuara tek institucionet qendrore*

4.5 QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

4.5.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në agjencitë vartëse

Qeveria e Republikës së Kosovës, përfshirë Zyrën e Kryeministrit, ministritë dhe agjencitë tjera vartëse, gjatë vitit 2015 ka pranuar 887 kërkesa për qasje në dokumente publike.

Më poshtë është tabela që pasqyron numrin e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në agjencitë vartëse.

Tabela nr.7 :

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në agjencitë vartëse

	Emri i institucionit	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e pjeshme	Totali
1	Zyra e Kryeministrit	16	21	2	39
2	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>	230	15	0	245
3	<i>Agjencia e Shtetërore e Arkivave të Kosovës</i>	0	0	0	0
4	<i>Agjencia për Barazi Gjinore</i>	0	0	0	0
5	<i>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë</i>	22	1	24	47
6	<i>Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore</i>	1	0	0	1
7	Ministria e Integritit Evropian	7	1	0	8
8	Ministria për Komunitete dhe Kthim	5	0	0	5
9	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	13	0	0	13
10	<i>Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës</i>	0	0	0	0
11	<i>Agjencia Kadastrale e Kosovës</i>	0	0	0	0
12	Ministria e Punëve të Brendshme	8	1	0	9
13	<i>Policia e Kosovës</i>	1	0	1	2
14	<i>Akademia e Kosovës për Siguri Publike</i>	0	0	0	0
15	<i>Agjencioni për Menaxhim Emergjent</i>	0	0	0	0
16	<i>Agjencioni për Regjistrim Civil</i>	0	0	0	0
17	<i>Inspektorati Policor i Kosovës</i>	0	0	0	0
18	<i>Agjencioni i Kosovës për Forenzikë</i>	0	0	0	0

19	Ministria e Diasporës	11	0	0	11
20	Ministria e Administratës Publike	19	2	0	21
21	<i>Instituti i Kosovës për Administratë Publike</i>	0	0	0	0
22	<i>Agjencia e Shoqërisë së Informacionit</i>	0	0	0	0
23	Ministria e Infrastrukturës	8	0	0	8
24	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	4	0	0	4
25	<i>Instituti Pedagogjik</i>	0	0	0	0
26	<i>Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve</i>	0	0	0	0
27	<i>Qendra e Studentëve</i>	0	0	0	0
28	<i>Biblioteka Universitare</i>	0	0	0	0
29	<i>Agjencia e Kosovës për Akreditim</i>	1	0	0	1
30	<i>Agjencia për Aftësim Profesional dhe për të Rritur e Kosovës</i>	0	0	0	0
31	<i>Instituti Albanologjik i Prishtinës</i>	0	0	0	0
32	<i>Inspektoriati i Arsimit në Republikën e Kosovës</i>	0	0	0	0
33	<i>Instituti i Historisë</i>	0	0	0	0
34	<i>Instituti i Lepsaoviqit</i>	/	/	/	/
35	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	12	1	/	13
36	<i>Agjencioni Pyjor i Kosovës</i>	0	0	0	0
37	<i>Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë</i>	0	0	0	0
38	Ministria e Drejtësisë	7	0	0	7
39	<i>Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar</i>	0	0	0	0
40	<i>Shërbimi Korrektues i Kosovës</i>	0	0	0	0
41	Ministria e Financave	41	2	0	43
42	<i>Administrata Tatimore e Kosovës</i>	5	0	0	5
43	<i>Dogana e Kosovës</i>	266	0	0	266
44	<i>Agjencioni Qendror i Prokurimit</i>	0	0	0	0
45	<i>Njësia e Inteligjencës financiare</i>	0	0	0	0
46	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	7	0	0	7
47	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	29	0	1	30
48	<i>Biblioteka Kombëtare e Kosovës</i>	0	0	0	0

	<i>"Pjetër Bogdani"</i>				
49	<i>Teatri Kombëtar i Kosovës</i>	0	0	0	0
50	<i>Qendra Kinematografike e Kosovës</i>	0	0	0	0
51	<i>Galeria Kombëtare e Kosovës</i>	0	0	0	0
52	<i>Galeria e Ministrisë "Qafa"</i>	0	0	0	0
53	<i>Ansambli Kombëtar Shtetëror i Këngëve dhe Valleve "SHOTA"</i>	0	0	0	0
54	<i>Filarmonia e Kosovës</i>	0	0	0	0
55	<i>Kosovafilmi</i>	0	0	0	0
56	<i>Baleti i Kosovës</i>	0	0	0	0
57	<i>Muzeu i Kosovës</i>	0	0	0	0
58	<i>Instituti Arkeologjik i Kosovës</i>	0	0	0	0
59	<i>Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve</i>	0	0	0	0
60	<i>Qendrat Rajonale të Trashëgimisë Kulturore</i>	0	0	0	0
61	Ministria e Punëve të Jashtme	1	9	0	10
62	<i>Akademia diplomatike e Kosovës</i>	0	0	0	0
63	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	13	5	1	19
64	<i>Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës</i>	0	0	0	0
65	Ministria e Shëndetësisë	26	1	1	28
66	<i>Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës</i>	3	4	0	7
67	<i>Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale</i>	0	0	0	0
68	<i>Instituti i Kosovës për Shëndetësi Publike</i>	0	0	0	0
69	<i>Qendra Kombëtare për Transfuzion të Gjakut e Kosovës</i>	0	0	0	0
70	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	12	4	0	16
71	<i>Agjencia Kosovare e Standardizimit</i>	0	0	0	0
72	<i>Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare</i>	0	0	0	0
73	<i>Agjencia e Promovimit të Investimeve e Kosovës</i>	0	0	0	0
74	<i>Drejtoria e Akreditimit të Kosovës</i>	0	0	0	0

75	Agjencia e Metrologjisë së Kosovës	0	0	0	0
76	Agjencia për Pronësi Industriale	0	0	0	0
77	Inspektoriati i Tregut	0	0	0	0
78	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	11	2	3	16
79	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	6	0	0	6
		785	69	33	887

4.5.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Kosovës dhe në institucionet vartëse

Tabela e mëposhtme prezanton totalin e kërkesave për qasje në dokumente publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve vartëse duke përfshirë edhe mënyrën e trajtimit të kërkesave.

Tabela nr.8 :

Kërkesat e pranuar në ZKM dhe ministri, dhe ndaras kërkesat e pranuar në agjencitë vartëse

Institucioni/ njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e pjesshme	Totali
ZKM dhe Ministritë	256	49	8	313
Agjencitë e ZKM-së dhe të Ministrive	529	20	25	574
	785	69	33	887

Siç shihet në Tabelën nr.8 kemi bërë ndarjen e këtyre institucioneve në dy grupe;

- **Grupi i parë:** Zyra e Kryeministrit dhe Ministritë,
- **Grupi i dytë:** Agjencitë në përbërje të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.
- **Realizimi i qasjes në dokumente publike**

Gjatë vitit 2015, në Qeverinë e Republikës së Kosovës iu është dhënë qasje e lejuar 88.5 për qind e të gjitha kërkesave të pranuar, 7.78 për qind të tyre janë refuzuar, ndërsa qasje e pjesshme iu është dhënë 3.72 për qind e kërkesave të pranuar.




Figura 11.
Realizimi i të drejtës për qasje në dokumente publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës

- Dërgimi i përgjigjeve në kërkesa

Gjatë vitit 2015, në Qeverinë e Republikës së Kosovës janë dërguar 88.28 për qind e kërkesave në afat ligjor, ndërsa në 11.72 për qind të rasteve, përgjigjet janë dërguar me vonesë.




Figura 12.
Respektimi i afateve për dërgimin e përgjigjeve tek kërkuesit, nga Qeveria e Republikës së Kosovës

- Refuzimet

Nga të gjitha refuzimet e bëra gjatë vitit të kaluar, 42 për qind ishin refuzime të pjesshme, po aq sa ishin edhe pa përgjigje. Nga të gjitha refuzimet e bëra, vetëm në 16 për qind ishin refuzime të plota.




Figura 13.
Refuzimet e bëra nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Numri i rishqyrtimeve

Kërkuesit e dokumenteve nuk kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre për të kërkuar rishqyrtimin e çështjes, sipas nenit 9 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Nga të gjitha refuzimet e pranuar vitin e kaluar, vetëm 22 për qind e tyre i janë drejtuar sërish institucioneve të ndryshme të Qeverisë, duke kërkuar që edhe njëherë të rishqyrtohet vendimi i marrë.



Figura 14.
Numri i rishqyrtimeve të kërkesave për qasje në dokumente publike tek Qeveria e Republikës së Kosovës

Nga këto rishqyrtime, institucionet qeveritare kanë vendosur të lejojnë qasjen në 40 për qind të rasteve, kanë refuzuar 53 për qind të këtyre kërkesave, ndërsa iu është ofruar qasje e pjesshme 7 për qind të kërkesve.




Figura 15.
